

101 GJUHA E NJËSISË

Kjo fushë përmban kodin e gjuhës së njësisë, pjesëve të saj, titullit si dhe gjuhës së origjinalit, nëse njësia që përshkruhet është përkthim.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
101	Gjuha e njësisë	nr
	a <i>Gjuha e tekstit</i>	r
	b <i>Gjuha e tekstit të ndërmjetëm</i>	r
	c <i>Gjuha e veprës origjinale</i>	r
	d <i>Gjuha e përmbledhjes</i>	r
	e <i>Gjuha e faqes së përmbajtjes</i>	r
	f <i>Gjuha e faqes së titullit</i>	r
	g <i>Gjuha e titullit të saktë</i>	nr
	h <i>Gjuha e libretit etj.</i>	r
	i <i>Gjuha e materialit shoqërues</i>	r
	j <i>Gjuha e titrave</i>	r

Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<i>Treguesi i përkthimit</i>
	0	<i>Njësia është në gjuhën origjinale të veprës</i> (shih shembujt 3, 5, 7, 12, 13, 14)
	1	<i>Njësia është përkthim</i> (shih shembujt 1, 2, 4, 6, 15)
	2	<i>Njësia përmban përkthime</i> (shih shembujt 8, 9, 10, 11)
2		<i>Nuk është i përcaktuar</i>

Vlera "2" nuk përdoret nëse përkthimet e vetme në botim janë përmbledhjet ose abstraktet e artikujve etj.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

101a Gjuha e tekstit

Gjuha e tekstit, e regjistrimit zanor etj. Nënfusha përsëritet nëse teksti është në disa gjuhë (shih shembujt 5, 7, 13, 14).

101b Gjuha e tekstit të ndërmjetëm

Gjuha e përkthimit të ndërmjetëm kur njësia nuk është përkthim i origjinalit (shih shembujt 2, 4, 6, 15). Nënfisha përsëritet nëse teksti është përkthyer nga disa gjuhë të ndërmjetme (shih shembullin 6), ose përmes disa gjuhëve të ndërmjetme (p.sh. Greqisht – Latinisht – Frëngjisht - Anglisht).

101c Gjuha e veprës origjinale

Gjuha e veprës origjinale, kur njësia që përshkruhet është përkthim (shih shembujt 1, 2, 4, 6, 8, 15). Nënfisha përsëritet nëse teksti origjinal është në disa gjuhë.

101d Gjuha e përmbledhjes

Gjuha e përmbledhjeve/abstrakteve të njësisë ose të pjesëve të veçanta apo artikujve që përmban njësia. Nënfisha përsëritet nëse njësia përmban përmbledhje në disa gjuhë (shih shembullin 7).

101e Gjuha e faqes së përmbajtjes

Gjuha e faqes së përmbajtjes, kur ndryshon nga gjuha e tekstit (shih shembullin 3). Nënfisha përsëritet për çdo gjuhë të përmbajtjes.

101f Gjuha e faqes së titullit

Gjuha e faqes së titullit, kur ndryshon nga gjuha ose gjuhët e tekstit (shih shembujt 3, 8). Nënfisha përsëritet për çdo gjuhë të faqes së titullit.

101g Gjuha e titullit të saktë

Gjuha e titullit të saktë, kur ndryshon nga gjuha e tekstit në nënfushën e parë ose të vetme a (shih shembullin 1). Nënfisha nuk është e përsëritshme, sepse titulli i saktë zakonisht është në një gjuhë. Nëse titulli i saktë është edhe në një gjuhë tjetër ai quhet titull paralel. Kodi për gjuhën e titullit paralel vendoset në nënfushën 200z.

101h Gjuha e libretit etj.

Gjuha e tekstit, kur njësia e përshkruar përfshin përmbajtje vokale (të folur ose të kënduar) në formë të shtypur, qoftë si material shoqërues ose si pjesë e njësisë. Nënfisha nuk përdoret vetëm për libreta (shih shembullin 9).

101i Gjuha e materialit shoqërues

Gjuha e materialit shoqërues si: parathënie, komente, udhëzime etj. (shih shembullin 10).

101j Gjuha e titrave

Gjuha e titrave të filmat, kur ndryshon nga gjuha e regjistrimit zanor (shih shembujt 11, 12).

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Në nënfushë vendoset kodi i gjuhës i përbërë nga tre karaktere, sipas standardit ISO 639-2. Kur nënfusha përsëritet, renditja e kodeve të vendosura duhet të pasqyroj shtrirjen dhe rëndësinë e gjuhëve të njësisë. Në qoftë se kjo është e pamundur, atëherë kodet e gjuhëve renditen në radhë alfabetike. Nëse nënfushën duhet përsëritur disa herë, atëherë mund të përdoret kodi "*mul*" – *shumëgjuhësh* (shih shembullin 8). Nëse gjuha nuk mund të përcaktohet, përdoret kodi "*und*" – *e papërcaktuar* (shih shembullin 16). Kodi "*zxx*" – *nuk ka përmbajtje gjuhësore* përdoret kur njësia nuk përmban fjalë të shkruara ose të folura, p.sh. materialet muzikore me nota, fotografitë etj. (shih shembullin 17).

FUSHAT NË LIDHSHMËRI

100h TË DHËNAT E PËRGJITHSHME PËR PËRPUNIMIN, Gjuha e katalogimit

Nënfusha përmban kodin e gjuhës që e përdor kataloguesi për ato pjesë të regjistrimit, të cilat nuk varen nga gjuha e njësisë (p.sh. shënimet).

200 TITULLI DHE TË DHËNAT PËR PËRGJEGJËSINË

Gjuha e titullit paralel, që shfaqet në këtë fushë, vendoset në nënfushën 200z.

510-541 TITUJT NË LIDHSHMËRI

Disa fusha të bllokut 5XX kanë nënfushën z, ku vendoset kodi për gjuhën e titullit paralel, nëse ndryshon nga gjuha kryesore e njësisë.

SHEMBUJ

1.

101	1□	afre ceng geng (<i>Libri me titull "Guidebook to Henry VIII's Palace of Hampton Court" është përkthim në frëngjisht nga origjinali në anglisht. Titulli i saktë është në anglisht, dhe pasohet nga një titull paralel në frëngjisht; teksti është në frëngjisht.</i>)
-----	----	---

2.

101	1□	afre beng crus
-----	----	-----------------------

(Një material shkencor në rusisht, të cilën një agjenci ndërkombëtare e ka përkthyer në anglisht. Këtë tekst të ndërmjetëm (tekstin në anglisht) një institut kërkimor francez e ka përkthyer në frëngjisht.)

3.

101 0₁ **ajpn eeng feng**
(Një botim zyrtar japonez që ka përmbajtjen dhe faqen shitesë të titullit në anglisht; teksti është në japonisht.)

4.

101 1₁ **aeng bger crus**
(Ditari i një udhëtari me titull "Journey to Khiva through the Turkoman country" i autorit Nikolay Murav'yov. Originali në rusisht është përkthyer në gjermanisht dhe më pas nga gjermanishtja në anglisht.)

5.

101 0₁ **aeng awel**
(Botimi zyrtar i Gwent County Council me tekst paralel në dy gjuhë: anglisht dhe në gjuhën e Uellsit.)

6.

101 1₁ **aeng bger bfre cakk**
(Një tekst në gjuhën e vjetër Akkadian, është përkthyer një pjesë në gjermanisht dhe një pjesë në frëngjisht. Përkthimi në anglisht është bazuar në përkthimin gjermanisht dhe frëngjisht.)

7.

101 0₁ **aeng afre ager deng dfre dger**
("IFLA Journal" përmban abstraktet nga të gjitha kontributet në anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht. Shumica e kontributeve janë në anglisht të ndjekura paralelisht dhe në frëngjisht dhe gjermanisht.)

8.

101 2₁ **amul ceng ffre**
(Libër për lexuesit francezë që ka faqen e titullit në frëngjisht dhe përmban përkthime nga anglishtja të akteve të dramave të Shekspirit në 25 gjuhë.)

9.

101 2₁ **afre hfre hger**
(Regjistrim zëri, këngë në frëngjisht me tekst shoqërues në frëngjisht dhe gjermanisht.)

10.

101 2₁ **azxx ieng**
(Regjistrim zëri që nuk ka tekst, mirëpo shënimet janë në anglisht.)

11.

101 2₁ **aswe jfre**
(Filmi "Tystnaden" i Bergman me titra në frangjisht.)

12.

101 0₁ **azxx jeng**
(Filmi "Modern Times" i Chaplin me titra në anglisht.)

13. *

101	0□	aeng afre
200	1□	a Annotated bibliography of national sources of adult education statistics <i>(Bibliographie annotée des sources nationales de statistiques sur l'éducation des adultes (Botimi është në dy gjuhë paralele, në anglisht dhe frëngisht.)</i>

14. * COBISS.net

101	0□	ascr aeng ager
200	1□	a Radovi <i>(Serial me tekst në tre gjuhë.)</i>

15. * COBISS.net

101	1□	aalb bger cchi
200	0□	a Kur Kina ende kishte shpresë
300	1□	a Përkthim i: Pekingmensch <i>(Libri është përkthyer në gjuhën shqipe, bazuar në përkthimin gjerman.)</i>

16. *

101	1□	aeng cund
200	1□	a Fear f [edited by Monica Narula, Shuddhabrata Sengupta, Jeebesh Bagchi g translations Shveta Sarda] <i>(Gjuha e tekstit origjinal nuk dihet ose nuk mund të verifikohet, për këtë arsye në nënfushën 101c shënohet kodi "und" – e papërcaktuar.)</i>

17. * COBISS.net

101	0□	azxx fslv
200	0□	a 25 vjet të bendit të zjarrëfikësve Lovrenc në Pohorje b Regjistrim zanor f [dirigjent Andrej Branko] <i>(Burimi përmban instrumentale muzikore. Për shkak se materiali nuk ka tekst, në nënfushën 101a vendoset kodi "zxx" – nuk ka përmbajtje gjuhësore. Plotësohet edhe nënfusha 101f, ku vendoset kodi i gjuhës së faqes së titullit.)</i>